



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, Trupi Gjyqësor më 19 shtator, miratoi kërkesën e Prokurorisë për të pranuar si prova tri deklarata të dëshmitarëve dhe provat materiale shoqëruese të tyre, pasi ata të jenë paraqitur në gjykatë. Trupi Gjyqësor konstatoi se vlera provuese e deklaratave nuk zhbëhet prej çfarëdo efekti dëmtues, veçanërisht duke marrë parasysh se Mbrojtja ka mundësinë të marrë në pyetje dëshmitarët. Trupi Gjyqësor konstatoi gjithashtu se pranimi i deklaratave me shkrim ndihmon shpejtësinë e procesit, sepse do të pakësojë konsiderueshëm numrin e orëve që nevojiten për marrje në pyetje nga pala thirrëse.

Më 20 shtator, Trupi Gjyqësor miratoi dy kërkesa të Prokurorisë për të lejuar dhënien e dëshmisë nga dy dëshmitarë nëpërmjet videokonferencës, për shkak të rrethanave personale të tyre. Trupi Gjyqësor ishte bindur se dhënia e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës nuk i shkakton dëm Mbrojtjes dhe përputhet me mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre, sepse dëshmitarët do të merren në pyetje në të njëjtat kushte sikurse në sallë të gjyqit.

Gjatë javës, tre dëshmitarë të thirrur nga Prokuroria dhanë dëshmi para gjykatës. Sipas përmbledhjes së Prokurorisë, i pari Demush Krasniqi, iu bashkua UÇK-së afërsisht në maj 1998 dhe më vonë shërbeu si anëtar i policisë ushtarake të Brigadës 122. Dëshmitari i dytë dha dëshmi me masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë të mbyllur. Dëshmitari i tretë filloi dhënien e dëshmisë sot paradite me masa mbrojtëse. Sipas përmbledhjes së Prokurorisë, dëshmitari u arrestua nga disa anëtarë të UÇK-së më 1999 dhe u dërgua në kompleksin e UÇK-së ku u keqtrajtua. Deri tani, 91 dëshmitarë kanë dhënë dëshmi para gjykatës në këtë çështje gjyqësore.

Seanca e ardhshme në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të hënë, 30 shtator, në orën 9:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore të Salih Mustafës, Kryetare Trendafilova më 23 shtator, caktoi Panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi kërkesën e përbashkët të Mbrojtësit të Viktimave dhe Prokurorisë për shtyrje të afatit për kërkesat e tyre referuese në lidhje me kundërshtime të mundshme të vendimit të fundit të Gjykatës Supreme dhe dënimit të ri të mëpasshëm për z. Mustafa, i cili u shpall nga Paneli i Apelit më 10 shtator. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese më 25 shtator hodhi poshtë tërësisht kërkesën e tyre duke konstatuar se nuk ishte e nevojshme që për arsye të efikasitetit të procesit të "sinkronizojnë" afatet e tyre për parashtrime dhe se rrjedhimisht nuk kishin treguar arsye të vlefshme për kërkesën e tyre. Paneli i Gjykatës Kushtetuese përbëhet prej gjykatësve Vidar Stensland, Rumen Nenkov dhe Romina Inkuti.





Në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, Paneli i Apelit miratoi pjesërisht kërkesën e Prokurorisë dhe urdhëroi z. Shala të dorëzonte versionin e ndryshuar të njoftimit të tij për apel, ku të mos tejkalonte numrin e lejuar të fjalëve prej 3200 fjalësh. Trupi Gjykues konstatoi se disa pjesë të njoftimit të mëparshëm nuk ishin të qarta dhe nuk ishte respektuar numri i lejuar i fjalëve prej 3000 fjalësh dhe për këtë arsye nuk përputhej me Udhëzuesin e Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara. Megjithatë, për arsye të posaçme, Trupi Gjykues konstatoi se ishte e përshtatshme të miratonte një shtim të kufizuar të fjalëve të lejuara prej 200 fjalësh për t'i lejuar z. Shala përmbushjen e udhëzimeve të përcaktuara në Vendim.

Versioni i redaktuar publik i aktgjykimit në këtë çështje gjyqësore u bë i disponueshëm më 24 shtator 2024 dhe mund ta gjeni në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

Në çështjen gjyqësore të Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës, Trupi Gjykues caktoi konferencat përgatitore për gjykim nga 7 deri më 9 tetor, nga ora 9:30 deri 17:30, ku 10 dhe 11 tetori janë ditë rezervë në rast se nevojitet kohë shtesë. Përveç Trupit Gjykues, në seancat pritet të jenë të pranishëm Prokuroria, Mbrojtja dhe Zyra Administrative. Trupi Gjykues urdhëroi Prokurorinë dhe Njësinë për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve të japin informacion të përditësuar në lidhje me sigurinë e dëshmitarëve dhe çështjeve lidhur me ta. Trupi Gjykues urdhëroi gjithashtu palët të dorëzojnë çdo parashtrim relevant para konferencave përgatitore, për shembull lidhur me statusin e hetimeve ose dëshmitarë të cilët synojnë të thërrasin. Trupi Gjykues bëri të ditur gjithashtu se seancat gjyqësore do t'i caktojë në një mënyrë që shfrytëzon plotësisht kohën në dispozicion në sallë të gjyqit dhe kërkoi nga Mbrojtja të bëjë të gjitha organizimet e nevojshme për të qenë të dispozicion të paraqiten gjatë seancave të caktuara. Trupi Gjykues urdhëroi palët të japin arsyet për çdo parashtrim konfidencial dhe të bëjnë të ditur kur ato të mund të riklasifikohen.

Data e parashikuar për fillimin e gjykimit është 11 nëntori, ku dëshmitari i parë i Prokurorisë pritet të paraqitet midis 11 dhe 15 nëntorit.

Më 19 shtator, Kryetarja Ekaterina Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës Supreme për të vendosur mbi kërkesën e Haxhi Shalës për rishikim të vendimit të Gjykatës Supreme në të cilin u hodh poshtë kërkesa e z. Shala për mbrojtjen e ligjshmërisë në lidhje me vazhdimin e paraburgimit të tij. Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se nuk kishte shkelje të konsiderueshme të procedurës nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, i cili fillimisht urdhëroi vazhdimin e paraburgimit, ose nga Paneli i Apelit i cili e konfirmoi vendimin. Duke qenë se z. Shala kërkon rishikim të vendimit të mëparshëm, Kryetarja caktoi të njëjtit gjykatës, Ekaterina Trendafilova, Kristinë van de Vajngart dhe Daniel Fransen.

Më 18 shtator, Gjykatësja e Vetme hodhi poshtë kërkesën e Isni Kilajt për ndryshim të përkohshëm të kushteve në fuqi për lirim të tij, për t'i lejuar z. Kilaj udhëtim në Shqipëri për një pushim të shkurtër. Gjykatësja e Vetme konstatoi se ekzistenca e rrezikut të arratisjes të konstatuar më parë është rritur me parashtrimin e aktakuzës së ndryshuar më 28 qershor. Ajo konstatoi gjithashtu se ndryshimet e kushteve të propozuara nga Mbrojtja nuk trajtojnë mjaftueshëm rrezikun dhe do të zhbënin efektivisht garancitë tashmë





të kufizuara aktualisht në fuqi për uljen e rrezikut që z. Kilaj të pengojë procesin dhe/ose të kryejë krime të tjera. Gjithashtu, megjithëse Gjykatësja e Vetme pranoi se humbja e shumës së paguar si dorëzani mund të jetë faktor i qenësishëm shkrajues për mospërbushje të mundshme nga z. Kilaj, ajo rikujtoi gjithashtu se vetëm dorëzania asnjëherë nuk është gjykuar si e mjaftueshme për të ulur ose minimizuar rreziqet në lidhje me të.

